



UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE NE RAJON

FTESA PER OFERTË

PËR PJESËMARRJE NË PROCEDURËN E TENDERIT ME OBJEKT  
“PRODUKSION DHE POST PRODUKSION PËR 3 SPOTE PROMOVUESE QË DO  
REALIZOHEN NË TIRANË NË KUADËR TË PROJEKTIT ‘ UBSHR, MIKE E  
ZONJAVE KRIJUESE DHE GUXIMTARE’.

*Emri dhe Adresa e Autoritetit Kontraktor*

**Emri :** UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE NË RAJON;

**Adresa :** Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, Kati 2, Zyra 18, Tiranë;

**E-mail :** ubshr@tirana.al

Autoriteti Kontraktor, UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE NË RAJON do te zhvillojë procedurën e prokurimit me objekt: “Produksion dhe post produksion për 3 spote promovuese që do realizohen në Tiranë në kuadër të projektit ‘ Ubshr, mike e zonjave krijuese dhe guximtare’, me Fond limit 8,000 Euro me TVSH.

Operatori ekonomik pjesemarrës në oferte duhet të sigurojë:

- a) **Oferten financiare**
- b) **Specifikimet teknike**

Me poshte jepen te permbledhura specifikimet teknike qe UBSHR parashikon per realizimin e Spoteve Promovuese, te cilat duhet te jene te detajuara ne ofertat e cdo operatori ekonomik.

- Staf i nevojshem per realizimin e spoteve promovuese (bazuar ne lindjen e nevojës gjate xhirimeve si: regjizor, skenarist, producente, operatore, asistente, montazhier, intervistues apo gazetarë, etj),
- Te gjitha instrumentat dhe materialet e nevojshme për xhirimet (pajisje ndricimi dhe audio, dron, pajisje te realizimit te skenografise, etj)
- Të mund te krijoje montazhe me cilesite dhe specifikimet e duhura (efekte, muzike, grafike, titra)
- Realizuesi i spotit duhet te angazhohet te prodhoj spotin sipas kerkesave kohore te organizatoreve si dhe te mundesoje ndryshime te karakterit grafik per te qene ne perputhje me strategjine e UBSHR.

Bashkengjitur gjenden dokumentat standarde te procedures se tenderit te detajuara, te cilat ofertuesi ekonomik i interesuar duhet t'i siguroje dhe dorezoje prane zyrave te UBSHR dorazi ose me poste ne adresen si me siper.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave: 25. 01. 2021, ora 11:00.  
Afati kohor për hapjen e ofertave: 29. 01. 2021, ora 11:00  
Afati kohor për ekzekutimin: Menjëhërë pas lidhjes së kontratës

Çdo ofertë e marrë pas datës së mbylljes së tenderit nuk do të pranohet

Për çdo pyetje ose sqarim mund të na shkruani në e-mail: [ubshr@tirana.al](mailto:ubshr@tirana.al).

**Cdo person i interesuar mund te dorezoje dokumentat e tenderit mbi kete procedure duke u paraqitur pranë zyrave të Unionit ose me ane te postes ne adresen: Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, Kati 2, Zyra 18, Tiranë.**

DREJTORE EKZEKUTIV  
Andriola Kambo



d re  
ii

**DOKUMENTAT TË PROCEDURËS PROKURIMIT**  
**“PRODUKSION DHE POST PRODUKSION PER 3 SPOTE**  
**PROMOVUESE QË DO XHIROHEN NE TIRANË PËR**  
**ORGANIZATËN JO-FITIMPRURËSE “UNIONI I BASHKIVE**  
**SHQIPTARE NË RAJON”**

Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon (me poshte Unioni) është një bashkim vullnetar, i lirë dhe i pavarur i Komunave të: Prishtinës, Preshevës, Prizrenit, Tetovës, Çairit, Gostivarit, Ulqinit, Tuzit dhe Bashkisë së Tiranës. Ajo është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, joqeveritare e formës Shoqatë.

Shoqata me emrin UBShR është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 29.07.2019 me Nr. vendimi 6305. Regjistrim i saj është në përputhje me Ligjin Nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” dhe sipas Ligjit Nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” me nr NIPT L92006451C.

**Qëllimet kryesore të UBShR janë:**

- Të krijojë një platformë bashkëpunimi që do t’u lejojë bashkive/komuna anëtare të intensifikojnë shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës në fushat e urbanistikës, inovacionit, mjedisit, kulturës dhe formave të reja të financimit;
- Të ngrejë një Grup të Përhershëm Koordinator që ka për detyrë të ndërmjetësojë në mënyrë të pandërprerë komunikimin dhe bashkëpunimin konkret mes bashkive/komuna anëtare për të gjitha fushat me interes;
- Të zhvillojë shkëmbime të rregullta ekspertize, përvoje dhe projektesh që kanë rezultuar të suksesshme;
- Të krijojë rrjetëzimin e bizneseve në rajonin shqipfolës.
- Të zhvillojë rregullisht programe të përbashkëta kulturore e artistike;
- Të punojë për thithjen e fondeve dhe projekteve rajonale dhe ndërkufitare;
- Të krijojë mbështetje të ndërsjellë midis bashkive/komunave anëtare me masa, asete, ekspertizë, dhe personel në rast emergjencash.

**Objekti i veprimtarisë**

Për arritjen e qëllimeve të saj UBShR zhvillon një sërë veprimtarish, që kryesisht janë:

- Takime dhe aktivitete lobuese dhe avokatore për të mbrojtur interesat dhe përmbushur nevojat e anëtarëve;
- Veprimtari njohëse, informative e debatuuese me anëtarët e shoqatës;
- Botim periodik të nje Reviste apo Gazete të bashkive/komunave anëtare;
- Organizimi i tryezave të rrumbullakëta dhe seminareve për të diskutuar çështje të autoriteteve të qeverisjes vendore, të marrëdhënieve ndërqeveritare dhe legjislacionit.
- Trajnime, seminare me politikanët dhe punonjësit civil të administratës së bashkive;
- Këshillime dhe shërbime të tjera ndaj anëtarëve për të ndihmuar zbatimin e funksioneve në nivelet dhe standartet e kërkuara dhe të dëshiruara;
- Kryerja e sondazheve për çështje me interes të përbashkët të anëtarëve të UBSHR;
- Sensibilizimi i publikut, nëpërmjet medias dhe rrjeteve sociale, për çështjet dhe interesat e bashkive/komunave;
- Kërkime në fusha dhe çështje me interes për anëtarët;
- Pjesëmarrje aktive në takime apo ngjarje të organizmave kombëtare dhe ndërkombëtare ku ftohet apo është anëtare.

Me qëllim përmbushjen e misionit dhe plotësimin e nevojave të veta, ky autoritet kërkon të blejë **një shërbim prodhues dhe post prodhues për realizimin e tre spoteve promovuese që do të xhirohen në qytetin e Tiranës, në kuadër të projektit “UBSHR, mike e zonjave krijuese dhe guximtare”**; përmes procedurës së tenderimit, duke respektuar parimin e paaftësisë, transparencës, barazisë, dhe efikasitetit ekonomik.

Për sa më sipër, Unioni i fton të gjithë operatorët e interesuar të paraqesin ofertat e tyre duke përmbushur kriteret si më poshtë:

- 1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.
- 1.2 Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Unioni nuk është përgjegjës për këto kosto.
- 1.3 Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës.
- 1.4 Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.
- 1.5 Oferta duhet të përfshijë Formularin e Ofertës ekonomike plotësuar sipas Shtojcës 1 të këtyre dokumentave dhe dokumentacionin e cituar në seksionin 2 të këtyre dokumentave;

## **Seksioni 2 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik**

Ofertuesi duhet të dorëzojë si pjesë të ofertës së tij, së bashku me formularin e ofertës dokumentat që vërtetojnë se operatori:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ka status aktiv dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit
- b) CV profesionale
- c) Te dhënat bankare
- c) Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike
- d) Formulari i ofertës ekonomike;

## **Seksioni 3 Përlllogaritja e ofertës ekonomike**

- 3.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto Dokumenta , duke përcaktuar mallrat/shërbimet që do të lëvrohen, sasinë dhe çmimin e tyre.
- 3.2 Të gjitha çmimet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek) ose në Monedhën Euro (EUR), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, përfshirë TVSH.
- 3.3 Çmimet e dhëna nga Ofertuesi duhet të jenë të fiksuara përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ndryshimi në asnjë aspekt. Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm, dhe që nuk është në përputhje me këtë paragraf, do të refuzohet nga Unioni si e papranueshme.
- 3.5 Ofertuesi duhet të përgatitë ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
- 3.6 **Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës**

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave dhe zgjat 30 ditë. Në çdo rast, të paktën 5 ditë nga përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshëminë e ofertave, Unioni mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Unionit lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, atëherë Unioni do të refuzojë ofertën.

## **Seksioni 4. Vlerësimi i Ofertave**

Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit do të kryhet brenda 5 diteve pune. Unioni vë në dijeni jo më vonë se 5 ditë nga marrja e vendimit me anë të komunikimit me email:

- a) çdo kandidat të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të pjesëmarrjes së tij në procedurë;

- b) çdo ofertues të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të ofertës së tij;
- c) çdo ofertues të suksesshëm, që ka paraqitur një ofertë të vlefshme, për klasifikimin e ofertave së përzgjedhur.

## **Seksioni 5. Specifikimet teknike**

Operatori ekonomik duhet të sigurojë të gjitha instrumentat dhe materialet e nevojshme për xhirimet ku përfshin:

- stafin e nevojshëm për realizimin e Spoteve Promovuese si regjizor, skenarist, kameraman, montazhier, etj;
- materialet ndihmese, dhe instrumenta të nevojshëm si pajisje ndricimi, efekte audio, dron, kamera, etj;
- realizimin e montazheve me cilesite dhe specifikimet e duhura (efekte, muzike, grafike, titra)

Realizuesi i spotit duhet të angazhohet të prodhojë spotin sipas kërkesave kohore të organizatoreve si dhe të mundesoje ndryshime të karakterit grafik për të qene në përputhje me strategjinë e UBSHR.

## **Seksioni 6. Nënshkrimi i Kontratës**

### **5.1 Njoftimi i fituesit**

Unioni njofton Ofertuesin fitues, si edhe të gjithë pjesëmarrësit për renditjen përfundimtare të ofertave me ane të komunikimit me email, brenda 5 ditëve pune nga marrja e vendimit.

Brenda 5 diteve nga njoftimi i fituesit nënshkruhet kontrata e blerjes me operatorin fitues ku saktësohen të drejtat dhe detyrimet reciproke.

**Shtojca 1**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik ]

**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**

Emri i Ofertuesit \_\_\_\_\_

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

\* \* \*

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

**Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lekë ose Euro

**Shtojca 2**

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]*

**DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
REALIZIMIN E OBJEKTIT SIPAS GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga UBSHR me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit 8,000 EURO.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e personit fizik/juridik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

Përmbush të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetoj këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga Unionit), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë, si dhe marrim përsipër realizimin e shërbimit sipas kohës të lëvrimit të kërkuar nga Unioni.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi** \_\_\_\_\_

**Vula** \_\_\_\_\_